NEWSLETTER
PUBLIKIM I EDEM

USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

EDEM
ZHVILLIMI I NDËRMARRJEVE SHQIPTARE & SHËRBIMET E TREGJEVE TË EKSPORTEVE
ALBANIAN ENTERPRISE DEVELOPMENT & EXPORT MARKET SERVICES

EDEM NEWSLETTER ■ No 3, June 2005 Botim i Projektit EDEM ■ Nr. 3, Qershor 2005

Tourism Industry

Albanian Travel Industry Hosts British and German Journalists

"Everything we discovered was the opposite — in a very good way — of what we expected," said Ms. Ute Müeller, Correspondent for the German newspaper Die Welt. "The EDEM project led us on a super tour of Albania. The sites, the countryside, the food and especially the people were incredible."



International journalists in Butrint / *Gazetarët e huaj në Butrint*

Five journalists from the UK and Germany were hosted by Albanian travel companies on a tour that the USAID-sponsored EDEM project organized from May 20-25. In addition to Ms Mueller, the group included Peter Lynch, correspondent for Northstar Media (one of the world's largest group of travel trade publications) who also writes for several newspapers in the UK and the US, Ms Polly Rodger Brown, a freelance journalist from London who writes for numerous British and international publications, and Ms Annette Pheiffer, Publisher and Editor of the German ecotourism magazine Nsb-Naturschutzblatter, who was accompanied by the magazine's chief photographer, Lothar Lindenhom. The group followed a popular tourist itinerary that took them from Tirana to Elbasan and then on to the Monastery of Ardenicë, Apollonia, Vlorë, Llogara, Himarë, Jal, Butrint, Sarandë, Gjirokastër, Berat and Durres.

Turizmi

Turizmi Shqiptar Mirëpret Gazetarët Britanikë dhe Gjermanë

"Çdo gjë që ne zbuluam ishte e kundërta – në kuptimin e mirë – e asaj që ne prisnim," thotë Znj. Ute Müeller, korrespondente e gazetës gjermane Die Welt. "Projekti EDEM na mundësoi një udhëtim të mrekullueshëm nëpër Shqipëri. Peisazhet, fshatrat, ushqimi, dhe veçanërisht njerëzit, ishin të jashtëzakonshëm."

Müeller dhe katër gazetarë të tjerë nga Anglia dhe Gjermania, u mirëpritën nga kompani shqiptare dhe ndërkombëtare në një udhëtim të organizuar nga projekt i USAID, EDEM nga 20-25 maj. Përveç Znj. Mueller, në grup ishin: Peter Lynch, korrespondent i Northstar Media (një nga grupet e botuesve më të mëdhenj botëror në biznesin e udhëtimeve,) që gjithashtu shkruan për disa gazeta në Britaninë e Madhe dhe ShBA; Znj. Polly Rodger Brown, gazetare e pavarur nga Londra, që shkruan për shumë botime britanike dhe ndërkombëtare, dhe Znj. Annette Pheiffer, botuese dhe kryeredaktore e revistës gjermane të ekoturizmit, Nsb-Naturschutzblatter, e shoqëruar nga fotografi kryesor i revistes, Lothar Lindenhom. Grupi ndërmorri një itenerar të njohur turistik, nga Tirana në Elbasan, dhe më pas në Manastirin e Ardenicës, Apolloni, Vlorë, Llogara, Himarë, Jalë, Butrint, Sarandë, Gjirokastër, Berat dhe Durrës.

Ardenica Monastery / *Manastiri i Ardenicës*


Peter Lynch

Annette Pheiffer


Lothar Lindenhom

For Peter Lynch, this tour of "Albania was a real eye-opener…I was totally unaware of the rich history and traditions of the country," he said. "It made quite an impression – a positive impression – to experience a country that is in the throes of a dramatic transition. It is a tourist destination today, which has great potential for the future."
"Media coverage is the best form of marketing and advertising for a destination," said EDEM tourism consultant, Scott Wayne. "We worked closely with the journalists during their visit and will continue to work with them to maximize the coverage of Alban
-ian tourism." Wayne continued that "Albania was not difficult to sell to journalists. They are intrigued by the country and believe that their readers will also be curious and want to learn more about what Albania has to offer visitors."

This is the second tour organized by EDEM for foreign journalists to experience Albania. This tour was sponsored by many active players in Albania's travel industry who recognize the value of spreading the word about Albania through the international press. Among the main sponsors were: Malev and Austrian Airlines, Albanian American Bank, Real Skampis Hotel and Restaurant in Elbasan, Hotel International and the Touristic Complex Liro in Vlorë, Gerbi in Jal, Hotel Kaonia in Sarande, Hotel Tomorri and Castle Park Hotel and Restaurant in Berat, Shkodra Travel Agency, Gulliver Tour Agency, the Poseidon Company in Lezha, and the Cities of Himare and Sarande. In addition, several American Peace Corps Volunteers and local citizens provided excellent guide service as the journalists "discovered Albania". ■

Për udhëtimin nëpër Shqipëri Peter Lynch shprehet "na u çelën sytë … isha krejtësisht i painformuar mbi historinë e pasur dhe traditat e vendit. Ishte një impresion i vërtetë – një impresion pozitiv – të vizitosh një vend që ndodhet në mes të një tranzicioni dramatik. Sot është një destinacion turistik, që ka një potencial të madh për të ardhmen."

"Prezantimi në media është forma më e mirë e marketingut dhe reklamës për një destinacion," thotë Konsulenti i EDEM për Turizmin, Scott Wayne. "Ne punuam dhe do të vazhdojmë të punojmë ngushtë me gazetarët për të bërë më të mirën për reklamimin e turizmit shqiptar". Wayne vazhdon: "Shqipëria nuk qe e vështirë për t'iu servirur gazetarëve. Ata u intriguan nga vendi dhe besojnë që edhe lexuesit e tyre do të kërkojnë të mësojnë më shumë mbi atë që Shqipëria mund t'u ofrojë vizitorëve."

Ky është udhëtimi i dytë i organizuar nga EDEM me gazetarë të huaj që eksplorojnë Shqipërinë. Ai u sponsorizua nga shumë pjesëmarrës të industrisë të turizmit, të cilët i njohin vlerat e reklamimit të Shqipërisë përmes shtypit ndërkombëtar. Midis sponsorëve kryesorë përmendim: Malev dhe Austrian Airlines, Albanian American Bank, Real Skampis Hotel Restorant në Elbasan, Hotel International dhe Kompleksi Turistik Liro në Vlorë, Gërbi në Jal, Hotel Kaonia në Sarandë, Hotel Tomorri dhe Castle Park Hotel Restorant në Berat, Shkodra Travel, Gulliver Travel Agency, Kompania Poseidon në Lezhë, si dhe qytetet Himarë dhe Sarandë. Përveç kësaj, vullnetarë të Korpusit Amerikan të Paqes dhe qytetarë vendas shërbyen si guidë e shkëlqyer në momentet kur gazetarët "zbulonin Shqipërinë". ■

Albanian stand in ITB / *Stenda shqiptare në Panairin e Berlinit*

International Tourism – Berlin, Germany

In March, with USAID sponsorship through its par-ticipant Training Program, the EDEM tourism team arranged for a group of Albanian tourism industry members to visit ITB, the world's largest travel trade fair. The main purposes of the visit were to introduce Albanian tourism businesses to the challenges and benefits of becoming competitive in the world's tourism market and for the businesses to make valuable contacts with international businesses exhibiting at ITB.

ITB 2005 attracted over 10,000 exhibitors from nearly every country and territory in the world. Over 142,000 visitors came to ITB, a third of which were trade visitors. There were 26 exhibit halls at Messe Berlin. The physical space is so vast and spread out that Messe Berlin has its own internal system of shuttle buses.

Not surprisingly, with so many exhibitors and visitors from around the world, ITB is one of the world's best sources for gauging world tourism trends. For the first time, ITB offered a "Business Travel@ITB Berlin" segment with a dedicated "ITB Business Travel Lounge." They also offered a "Trends & Events" hall, which included tour operators who specialize in ecotourism, experiential travel, travel for the disabled, gay travel and a youth travel center.

The EDEM team and businesses met with 21 tour operators interested in expanding their operations to include Albania and learned more about the high standards required by operators when entering a new market. They all returned home recognizing that there is definitely additional work needed to strengthen Albania's tourism image in general and especially at ITB. ■

Turizmi Ndërkombëtar – Berlin, Gjermani

Me sponsorizim të USAID, përmes Programit të Trainimeve, stafi i EDEM organizoi vizitën e një grupi nga industria shqiptare e turizmit në Panairin më të madh Ndërkombëtar të Turizmit në Berlin (ITB). Qëllimi i kësaj vizite ishte prezantimi i bizneseve shqiptare të turizmit me sfidat dhe përfitimet që sjell të qenit konkurues në tregun ndërkombëtar të turizmit, si dhe realizimin e kontakteve të vlefshme me pjesëmarrës në Panair..

ITB 2005 tërhoqi mbi 10,000 pjesëmarrës nga pothuajse të gjitha vendet e botës. U vizitua nga më shumë se 142,000 vizitorë, 1/3 e të cilëve ishin vizitorë tregtarë. Pati 26 holle ekspozimi. Duke patur parasysh sipërfaqen e madhe të shtrirjes, Messe Berlin ka realizon lëvizjen e brendshme nëpërmjet autobuzave.

Visitors in the Albanian stand in ITB / *Vizitorë në stendën shqiptare*

Me kaq shumë pjesëmarrës dhe vizitorë nga e gjithë bota, padyshim që ITB është një nga burimet më të mira për vlerësimin e tendencave ndërkombëtare të turizmit. Për herë të parë ITB ofroi segmentin "Business Travel@ITB Berlin", me "Pavionin e Udhëtimeve të Biznesit ITB". Gjithashtu u ofrua edhe Pavioni "Tendenca & Aktivitete", i cili përfshiu operatorë turistikë të specializuar në ekoturizëm, udhëtime eksperience, për persona me aftësi fizike të kufizuara, për homoseksualë, dhe një qendër udhëtimesh për të rinj.

Stafi i EDEM dhe bizneset e turizmit u takuan me 21 operatorë turistikë të interesuar në përfshirjen e Shqipërisë në aktivitetet e tyre dhe mësuan më tepër për standartet e larta të kërkuara nga shumë operatorë me hyrjen në një treg të ri. Pjesëmarrësit e këtij udhëtimi studimor patën gjithashtu rastin të krahasojnë stendën e Shqipërisë me stendat e shumë vendeve të tjera. Ata u kthyen të ndërgjegjësuar që padyshim kërkohet më shumë punë për forcimin në përgjithësi të imazhit të turizmit shqiptar, dhe sidomos në Panairin e Berlinit. ■

Tourism in Voskopojë, Korça and Pogradec

"Next year, Korça and Voskopojë need to be at ITB," said Dritan Naumi, ITB study tour participant and EDEM tourism cluster member. Dritan is the manager of the Hotel Akademia in Voskopojë. "I need to inform people in my region about the importance of ITB and putting more importance on tourism."

To support his efforts in raising awareness,the EDEM team met with the Head of Commune of Voskopojë, Nexhip Bacelli and discussed some of the local issues impacting tourism development. He was particularly concerned about the garbage problem and was looking for solutions. Mr. Bacelli said that the community is concerned and willing to contribute funds towards addressing the collection and land-fill issues.

The EDEM tourism team also presented the results of ITB and discussed the economic importance of tourism with Korça Mayor, Berti Dhamo, and other local community stakeholders at GTZ's office in Korça. The stakeholders explained that Korça is working on the establishment of a consensus-building process for tourism development. As the process moves forward, EDEM has offered to provide advice, especially on best practices of tourism development.

The team also met with the Mayor of Pogradec, Artan Shkëmbi, who had just returned from a special tourism promotional visit to Copenhagen. He organized an Albanian night with the assistance of the Albanian Ambassador to Denmark. Albanian music and dances were performed by a group from Pogradec. The Mayor also arranged for Koran trout to be served with local wine at the celebration. One of the immediate results was a tour group booking for a visit to Pogradec. ■

Pogradec

Turizmi në Voskopojë, Korçë dhe Pogradec

"Korça dhe Voskopoja duhet të jenë në Panairin Ndërkombëtar të Berlinit vitin që vjen", thotë manaxheri i Hotel Akademia në Voskopojë, Dritan Naumi, pjesëmarrës i udhëtimit studimor në ITB dhe anëtar i industrisë së turizmit. "Unë duhet të flas me njerëzit në këtë zonë për vlerën e këtij panairi si dhe rëndësinë që duhet t'i japim turizmit".

Në vazhdën e përpjekjeve për rritjen e ndërgjegjësimit mbi këtë sektor, stafi i EDEM paraqiti rezultatet e ITB-së dhe diskutoi rëndësinë ekonomike të turizmit me Kryetarin e Bashkisë së Korçës, Berti Dhamo, dhe pjesëmarrës të tjerë të rëndësishëm të këtij komuniteti në zyrat e GTZ-së në Korçë. Këta pjesëmarrës shpjeguan që Korça po punon për zbatimin e një proçesi të ndërtuar në bazë të një konsensusi për zhvillimin e turizmit.

Stafi i EDEM u takua gjithashtu edhe me Kryetarin e Komunës së Voskopojës, Nexhip Bacelli dhe diskutoi me të disa probleme të zonës që kanë efekt mbi zhvillimin e turizmit. Veçanërisht ai shprehu shqetësim për problemin e mbeturinave në kërkim të zgjidhjeve të mundshme. Kryetari Bacelli tha që komuniteti është i shqetësuar dhe i gatshëm të kontribuojë me fonde për mbledhjen dhë groposjen e mbeturinave.

Stafi u takua gjithashtu me Kryetarin e Bashkisë së Pogradecit, Artan Shkëmbi, i sapo kthyer nga një vizitë për promovimin e turizmit në Kopenhagen, ku me ndihmën e ambasadorit shqiptar në Danimarkë organizoi Natën Shqiptare. U luajt muzikë dhe u kërcyen valle shqiptare nga një grup pogradecar. Kryetari Shkëmbi mundësoi servirjen në aktivitet të peshkut koran dhe verës vendase. Si rezultat i kësaj një grup turistësh prenotuan një vizitë në Pogradec. ■

Voskopojë

Kosovo and Macedonian Tourism Trade Shows

On May 10th in Pristina, Kosovo and again on May 11th and 12th in Skopje, Macedonia, tourism trade fairs were organized to promote Albania as a favorable destination for Kosovars and Macedonians. The fairs were organized by the National Commercial Bank, the Ministry of Tourism and Territory Adjustment, and EDEM

Each fair had two components – an opportunity for local businesses to meet and interact with Albanian tourism operators (hotels, tour operators and others), and a session open to the public where Albanian businesses had the opportunity to display their products to the citizens of Kosovo and Macedonia. Over 50 Albanian tourism organizations from different regions of Albania, participated in the two events and displayed their capacity to welcome tourists during the Summer 2005.

In addition to showcasing Albania to the public, extensive contact occurred between the businesses from the three countries, especially between those from Macedonia and Albania. From these contacts, joint efforts such as marketing, packaged tours and future events will be developed. Important to these efforts, Albania is now seen not only as a place for seaside vacations, but also has many historic and cultural sites well worth a visit. ■

Albanian stand in Kosovo and Macedonia Fairs/ *Stenda shqiptare në panairet e Kosovës dhe Maqedonisë*

Panairet e turizmit në Kosovë dhe Maqedoni

Participants and EDEM staff at the Kosovo and Macedonia Fairs/ *Pjesëmarrës dhe stafi i EDEM-it në panairet e Kosovës dhe Maqedonisë*

Në 10 maj, në Prishtinë dhe në 11-12 maj në Shkup u zhvilluan Panaire për promovimin e Shqipërisë si destinacion i favorshëm turistik për pushuesit kosovarë dhe maqedonas. Panairet u organizuan nga Banka Kombëtare Tregtare, Ministria e Turizmit dhe Rregullimit të Territorit dhe EDEM.

Secili Panair pati dy komponentë – së pari, mundësinë që bizneset lokale të takoheshin dhe të bashkëpunonin me operatorët turistik shqiptarë dhe një panair të hapur për publikun, ku bizneset shqiptare shfaqën për qytetarët kosovarë dhe maqedonas produktet e tyre turistike. Mbi 50 biznese, përfaqësues të industrisë nga rajone të ndryshme të Shqipërisë, morëm pjesë dhe prezantuan në të dy Panairet kapacitetet e tyre për të pritur turistët në verën e 2005.

Përveç prezantimit të Shqipërisë në publik, kontakte të shumta u bënë mes bizneseve të tre vendeve, sidomos mes atij maqedonas dhe shqiptar. Si rezultat i këtyre kontakteve, do të realizohen shumë iniciativa të përbashkëta në marketing, paketa turistike e aktivitete të tjera të ardhshme. E rëndësishme për këtë aktivitet është që tashmë Shqipëria nuk shihet vetëm si një vend për të kaluar pushimet pranë detit, por ka edhe mjaft pika historike e kulturore që ia vlejnë të vizitohen. ■

"Welcome to Albania"

In May, Tirana Airport Partners (TAP), a German-American consortium led by the German company Hochtief, began development of a new international airport to serve Albania. The new airport will make a significant contribution to increasing tourism traffic to Albania. Already, negotiations are underway with several additional international carriers to begin flights to Albania from major European cities.

One of the first initiatives was the introduction of tourism information to the existing terminal's arrival area. With TAP support, EDEM sponsored the placement of a tourism brochure display in this area. Tourism cluster members from all around Albania have been invited to provide brochures for the stand. The success of making this information available to incoming visitors has created a welcomed challenge to EDEM keeping the stand stocked with brochures and information about Albania. TAP is planning for a full service tourism information office at the new airport terminal. ■

Arrival area at Mother Teresa Airport / *Stenda informative në terminalin e mbërritjes së pasagjerëve*

"Mirë se vini në Shqipëri!"

Tourist information at Mother Teresa Airport / *Stenda informative në Aeroportin "Nënë Tereza"*

Në muajin maj konsortiumi amerikano-gjerman, Tirana Airport Partners (TAP), i kryesuar nga kompania gjermane Hochtief, filloi ndërtimin e një aeroporti të ri ndërkombëtar në shërbim të Shqipërisë. Aeroporti i ri do të japi një kontribut të madh në rritjen e numrit të turistëve që vijnë në vend. Që tani, kanë filluar negociatat me shumë kompani ndërkombëtare fluturimi për të filluar fluturimet drejt Shqipërisë nga qytete kryesore europiane.

Një nga iniciativat e para ishte prezantimi me një stende informacioni të turizmit në terminalin e mbërritjes së pasagjerëve në aeroport. Me mbështetjen e TAP, EDEM sponsorizoi vendosjen e një stende broshurash turistike në këtë zonë. Anëtarë të klasterit të turizmit nga e gjithë Shqipëria u ftuan të sjellin broshura për këtë stendë. Ofrimi me sukses i këtij informacioni për vizitorët dhe mbushja e kësaj stende me broshura informative mbi Shqipërinë ka qenë një sfidë e mirëpritur nga EDEM. TAP po planifikon një zyrë të veçantë informative mbi turizmin në terminalin e ri të aeroportit ■

Herb and Spice Industry

Herbs & Spice International B2B

EDEM staff and businesses in Skopje / *Stafi i EDEM-it dhe tregtarë të bimëve në Shkup*

Recently, eight Albanian herbs and spice companies, with assistance from EDEM, had the opportunity to participate in an international Business 2 Business (B2B) meeting in Skopje, Macedonia. The event organized by the Swiss Import Promotion Program (SIPPO) and GTZ/ Belgrade Office attracted over 35 businesses from Macedonia, Bulgaria, Switzerland, Serbia & Montenegro, Bosnia and Herzegovina, and Germany.

The B2B, the first of its kind to be organized for the herb and spice businesses of the Balkan countries, offered Albanian companies an excellent chance to gain exposure to recent developments in regional and international markets. The Albanian businesses also were able to learn further about production diversification and adding value to products such as the production of higher quality products, organic certified products, and fully processed products.

The activity was a great opportunity to share experiences, introduce businesses' capacities and their range of products, discuss opportunities for future regional and European cooperation between businesses, as well as with donor programs and private institutions.

Attendance at the B2B provided extensive value to the participating Albanian firms, however, it's the follow-up to contacts made and implementation of ideas learned that will truly benefit the companies. EDEM will work directly with the participating firms by facilitating their contacts with regional counterparts and potential partners. EDEM will further assist the businesses by supporting their efforts to implement new initiatives they brought back from Skopje regarding quality improvements, new product developments, and organic certification. ■

Industria e Bimëve Aromatiko-Mjekësore

Takim Ndërkombëtar për Bimët Aromatiko-Mjekësorë

Së fundmi, tetë kompani shqiptare të bimëvë aromatiko-mjekësore patën mundësinë që me ndihmën e Projektit EDEM të marrin pjesë në një takim ndërkombëtar Biznesi me Biznesin (B2B) organizuar në Shkup, Maqedoni. Ky takim u organizua nga Agjencia Zvicerane për nxitjen e eksporteve (SIPPO) si dhe zyra e GTZ/Beograd. Në të morën pjesë rreth 35 biznese nga Maqedonia, Bullgaria, Zvicra, Serbia-Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina, si dhe Gjermania.

Takimi B2B, i pari i këtij lloji i organizuar në nivel ballkanik për bizneset e bimëve aromatiko-mjekësore, u ofroi kompanive shqiptare një shans të madh për t'u ballafaquar me zhvillimet më të fundit të tregjeve rajonale dhë ndërkombëtare. Bizneset shqiptare mësuan në të njëjtën kohë rreth shtimit të vlerës të produkteve të tyre, ndryshueshmërisë së gamës së produkteve (diversifikimit) – këto të dyja të realizuara përmes rritjes së cilësisë së produkteve, bioçertifikimit, si dhe përpunimit të thellë të tyre.

Albanian stand of Herbs and Spices/ *Stenda shqiptare e Bimëve Medicinale*

Ky aktivitet ishte një mundësi e madhe për ndarje përvoje, prezantim të kapaciteteve të bizneseve dhe larmisë së produkteve të tyre, për diskutime për bashkëpunime në të ardhmen të bizneseve rajonale dhe europiane, si dhe bashkëpunime të programeve donatore dhe institucioneve private.

Pjesëmarrja në takimin B2B – Shkup pati vlera të mëdha për kompanitë pjesëmarrëse, gjithësesi ndjekja në vazhdimësi e kontakteve të realizuara gjatë këtij aktiviteti, si dhe vënia në praktikë e ideve të përftuara gjatë takimit, do të jenë frytet e vërteta të këtij aktiviteti në përfitim të kompanivë. EDEM do të punojë drejtpërsëdrejti me bizneset që morrën pjesë në takim duke mundësuar kontaktet e tyre me bizneset homologë rajonale si dhe partnerët potencialë. EDEM do vazhdojë të ndihmojë bizneset në përpjekjet e tyre për materializmin e iniciativave të reja të lindura gjatë B2B-Shkup, që konsistojnë në përmirësimin e cilësisë, zhvillimin e produkteve të reja dhe bioçertifikimin. ■

Organic – Bio-certification

Lavender / *Lavandula*

As frequently mentioned, organically grown products are enjoying a significant upsurge in popularity among world consumers. To ensure reliability, an internationally recognized bio-certification process must be used by producers who want to enter their products in this lucrative market. Bio-certification is a transparent process that ensures proper implementation of regulations ensuring that the products are chemical free; protects and increases reliability to the consumer; protects and increases reputation of producers; and creates new market opportunities.

Bio-certification is rapidly growing in favor within the Albanian herb and spice industry.

Bio-certification recognizes the excellent biological characteristics of Albanian herbs and spices; increases their competitiveness in international markets; and offers the opportunity for a premium pricing of up 20%.

EDEM is assisting interested Albanian herb and spice companies that want to go organic. Several international certifying bodies have been contacted by EDEM, which put them in touch with the Albanian companies. These companies are now in negotiation with a certifying organization that is internationally recognized in Europe, USA, and Japan. ■

Çertifikimi Organik

Shpesh flitet për produktet organike, konsumi i të cilave po rritet ndjeshëm në mbarë botën. Për të siguruar besueshmëri, prodhuesit, të cilët dëshirojnë t'i futin produktet e tyre në tregje fitimprurëse, duhet t'i bioçertifikojnë këto produkte nga trupa ndërkombëtare të akredituara. Bio-çertifikimi është një sistem transparent që siguron zbatimin korrekt të standarteve për t'u siguruar që produktet janë të patrajtuar me kimikate; ky sistem mbron dhe rrit besueshmërinë e konsumatorit, si dhe krijon mundësi të reja për tregje.

Bio-çertifikimi po kryhet me ritme të shpejta edhe brenda për brenda industrisë shqiptare të bimëve aromatiko-mjekësore.

Bio-çertifikimi vërteton karakteristikat biologjike të shkëlqyera të bimëve aromatiko-mjekësore shqiptare; rrit konkurueshmërinë e tyre në tregjet ndërkombëtare dhe ofron mundësi për shtesë në çmim deri në 20%.

Projekti EDEM po ndihmon kompani shqiptare të interesuara për t'u bioçertifikuar. EDEM ka kontaktuar disa trupa ndërkombëtare bioçertifikuese dhe mundësoi kontaktet e tyre me kompanitë shqiptare. Këto të fundit janë në negociata me një trup biocertifikuese ndërkombëtare dhe e akredituar që njihet në Europë, SHBA dhe Japoni. ■

Bio-Certified Products/ *Produkte të bio-çertifikuara*

Cultivation – An Alternative to Wild Collection

Cultivation sites in Polican/ *Kultivimi në Poliçan*

Conventional wild harvesting remains the main source of gathering natural aromatic and medicinal plants. However, cultivation of herbs and spices with significant commercial values is becoming an increasingly viable alternative as the economics become more positive, as well as to offset the decreasing labor availability as more and more rural people migrate to the cities. Cultivation is also a very important mitigating tool to ensure wild supplies maintain their sustainability.

Cultivation practices date far back into history. In Albania, the cultivation of herbs and spices is undergoing revitalization. An example of the increasing interest on commercial cultivation is the initiative of the recently established Essence Producers and Cultivators Association (EPCA). Xherdo Company, a member of EPCA has established cultivation of Sage, Rosemary, Thyme, Melissa, and Oregano in the Poliçan area. The seedlings planted were grown in Vora using high quality Dutch seed and an organically certified process.

For further information with regard to the feasibility and agro-technical recommendations for cultivation, please contact the EDEM office.■

Kultivimi - Një Alternativë ndaj Bimëve të Egra

Bimët e egra konvencionale mbeten burimi kryesor i grumbullimit të bimëve aromatiko-mjekësore. Megjithatë, kultivimi i këtyre bimëve me vlera të rëndësishme tregtare po shndërrohet në një alternativë reale falë treguesve ekonomikë pozitivë si dhe përballë pakësimit dhe migrimit të fuqisë vjelëse në zonat urbane. Kultivimi është në të njëjtën kohë edhe një masë shumë e rëndësishme, që siguron shfrytëzim të qëndrueshëm të bimëve të egra.

Kultivimi ka fillesa të hershme në historinë e njerëzimit. Në Shqipri po ringjallen sërish praktikat e kultivimit të bimëve aromatiko-mjekësore. Shembull i rritjes së interesit mbi kultivimet me vlera komerciale është edhe iniciativa e Shoqatës së Kultivuesve dhe Prodhuesve të Esencave (EPCA). Kompania "Xherdo", anëtare e kësaj shoqate, po kultivon në zonën e Poliçanit bimët Sherebelë, Rozmarinë, Timus, Bar Blete dhe Rigon. Fidanët u përgatitën në Vorë duke përdorur fara hollandeze BIO; më pas ato u tranpslantuan në fushë të hapur.

Për informacione të mëtejshme lidhur me mundshmërinë dhe rekomandimet agro-teknike rreth praktikave të kultivimit, ju lutemi kontaktoni zyrat e EDEM-it. ■

Cultivation sites in Polican/ *Kultivimi në Poliçan*

Meat Processing Industry

MEAT MASTER – A Shkodra Tradition

The Shkodra-based Meat Master Company introduced visitors at the recently held Balkan Modus Nutriendi to the taste of Shkodra's long standing tradition of high quality dry meat production. So successfully was Meat Master in presenting its traditionally made products that the Company was recognized by the fair organizers in the form of an extraordinary award presented for "maintaining the quality and tradition of meat products".

Meat Master stand at the Trade Fair/ *Stenda e Meat Master*

At a special program held during the Fair, Meat Master presented its high value specialty dry products to Tirana and Durres retail markets, hotels and restaurants markets. The presentation launched a new marketing campaign, assisted by EDEM, to place the company's products in these markets and make them available to Albanian consumers who long for the taste of traditional products. ■

Industria e Përpunimit të Mishit

MEAT MASTER – Tradita Shkodrane

Kompania Meat Master me vendndodhje në Shkodër u prezantua së fundi para vizitorëve të shumtë në Panairin Balkan Modus Nutriendi me produktet e veta të cilësisë së lartë të sallamit të thatë tradicional shkodran. Për paraqitjen kaq të sukseshme Meat Master u nderua nga organizatorët e Panairit me çmimin e veçantë të "Ruajtjes së cilësisë dhe traditës së produkteve të mishit"

Në një aktivitet të veçantë të organizuar gjatë Panairit, Meat Master prezantoi për dyqanet, hotelet dhe restorantet në Tiranë dhe Durrës specialitetin mjaft cilësor të produkteve të thata. Gjatë prezantimit kompania shpalli fushatën e re të marketingut, e asistuar kjo edhe nga EDEM, për hedhjen e produkteve në këto tregje dhe mbrritjen tek konsumatori shqiptar, të cilit i mungon shija e sallamit tradicional. ■

Opportunities for Albanian Business to Expand Sales to Supermarkets

Recent expansion of large scale international retail chains across southeastern Europe is an indicator of what the near future holds for the Albanian retail market. The first hypermarket in Albania expects to open its doors this coming September. Euromax, which will be housed in the Univers Trade Center on the outskirts of Tirana, anticipates offering over 30.000 products in a 4,000 square meter facility and expects to draw up to 2 million customers annually. Euromax plans to open six other large retailing centers in other Albanian cities. In addition to Euromax, several other existing retail chains such as 'Xhea', 'Big Markets' and 'Extra' are currently opening additional stores in the Tirana and Durres areas.

Mundësi të Rritjes së Shitjeve në Supermarkete për Biznesin

Zgjerimi së fundmi i rrjetit të supermarketeve në gjithë Europën Juglindore është një tregues domethënës për të ardhmen e tregtimit me pakicë në Shqipëri. Hipermarketi i parë në Shqipëri do të hapë dyert në shtator të këtij viti. Me vendndodhje në Qendrën Tregtare Univers në km 6 të Autostradës, "Euromax" pritet të tregtojë mbi 30 000 produkte në 4000 m^2 dhe të tërheqi mbi 2 milionë blerës në vit. "Euromax" ka në plan të hapë në qytete të tjera edhe 6 pika të tilla shitjesh. Gjithashtu, edhe supermarkete të tjera në vend si "Xhea", "Big Markets" dhe "Extra" po hapin pika të tjera të tyre në Tiranë dhe Durrës.

These new large scale supermarkets will offer fierce competition to the numerous small scale retail shops that currently dominate Albania's retail market. The larger markets will compete by offering a much wider range of products, generally at lower prices. Opening modern supermarkets provides an interesting

Euromax, at the Univers Trade Center / Euromax në Qendrën Tregtare Univers

opportunity for Albanian producing companies to review their market strategies, diversify their production, and adopt new distribution channels.

